



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 1320 Prot.

Gjirokastrë, më 21.10.2022

**Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Shkollën  
Superiore të Konservimit dhe Restaurimit të Veprave Kulturore, Madrid.**

Në kuadër të Programit Erasmus+, Shkolla Superiore e Konservimit dhe Restaurimit të Veprave Kulturore ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:

- **3 pozicione** për staf akademik të cilët do të angazhohen në mësimdhënie për 7 ditë në Shkollën Superiore të Konservimit dhe Restaurimit të Veprave Kulturore.

Planifikimi i aktivitetit mësimor do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2022-2023**, semestri i parë ose i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B2. Sipas të dhënave nga Shkolla Superiore e Konservimit dhe Restaurimit të Veprave Kulturore, aplikimet janë të hapura për specialistë në fushën e restaurimit të veprave arkeologjike.

Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **28.10.2022**:

- një letër interesi në anglisht, e cila cilëson fushën tuaj studimore dhe që përshkruan ciklin e leksioneve që mendoni të zhvilloni në Shkollën Superiore të Konservimit dhe Restaurimit të Veprave Kulturore.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS, në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës së Shkollës Superiore të Konservimit dhe Restaurimit të Veprave Kulturore, Spanjë, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

**Prof. dr. Bektash Mema**

**REKTOR**

